



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më: Priljeno:	13.05	2025
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
05-453/01-24005		



KOMUNA E LIPJANIT

OPŠTINA LIPLJAN

MUNICIPALITY OF LIPJAN

Lipjan , 13.05.2025

Bazuar në Rregulloren e MF — NR-04 / 2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ- ve,

Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të Regjistruara në Republikën e Kosovës të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në Promovimin e kulturës dhe sportit në Komunën e Lipjani.

1. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekte në lëmin e kulturës dhe sportit në kuadër të ditëve të Diasporës, duke përfshirë organizimin e festivalit „Mërgata Fest & Sports 2025”

Objektivat e thirrjes:

- Promovimi i kulturës,
- Promovimi i sportit,
- Promovimi i ngjarjeve kulturore të qendrueshme

Aktivitete:

- Aktivitete sportive 5 ditore
- Festival 3 ditorë (koncert me këngëtarë eminent të vendit)
- Aktivitete tjera kulturore

2. Përfituesi do të kujdeset për:

- Sigurimi i ekipeve dhe sportistëve pjesëmarrës do t'i siguroj OJQ përfituese.
- Sigurimi i emrave të këngëtarëve eminent të cilat përcaktohen në bashkëpunim me DKRS-në, por që duhet të prezentohen si propozime në projekt.
- Sigurimin e Binës me dimensione 6m x 8m me LED 6 m x 3 m ,
- Sigurimin e zërimit profesional (i mjaftushëm për ambiente të jashtme)
- Sigurimin e mbrojtëseve rreth binës
- Sigurimin e 100 karrigeve për aktivitete
- Sigurimin e kamerave profesionale për xhirime te aktiviteteve dhe aparata fotografik profesional

3. Organizatat jo-qeveritare mund të aplikojnë me një projekt që kontribuojnë në Promovimi i kulturës dhe sportit në Komunën e Lipjani.

- Vlera totale e planifikuar sipas thirrjes është 50,000.00 euro (pesëdhjetë mijë euro)
- Numri i OJQ-ve që do të mbështeten nga kjo thirrje është një (1) OJQ.
- OJQ të do të financohen për këtë projekt nga 501.00 € deri në 50,000.00 €

4. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën 03.06.2025.

5. Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e Organizatave Jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës para datës së publikimit të thirrjes publike. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e sportit dhe kulturës. OJQ duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit.

6. Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ nuk është nën hetime për vepra penale.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare (<http://kk.rks-gov.net/lipjan/>).

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen personalisht, në adresën e mëposhtme:
KOMUNA E LIPJANIT

Rruga „Shqipëria”

Zyra për shërbim të qytetarëve , nr 2 dhe 3,

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

8. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: pranvera.i.krasniqi@rks-gov.net

Vërejtje: Aktivitetet e “Mërgata Fest & Sports” do të organizohen në sheshin “Adem Jashari” në Lipjan fundi i korrikut, fillimi i gushtit 2025.

Anila Reçica Llugini
Drejtoreshë e DKRS-së

